# Irena Gjoka

GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

**Deklaratat e analizuara:**

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto është rritur me 6.2 herë

\+ 888,119 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

**Likuiditete në Bankë**




**Likuiditete në Cash**




**Pasuritë e Luajtshme**




**Pasuritë e Paluajtshme**




**Huadhënie**




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura paga nga funksoni | 15,927,729 | 57.43% |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortit | 872,576 | 3.15% |
| Të ardhura nga biznesi "lojra fati" në emër të bashkëshortit | 10,160,000 | 36.63% |
| Të ardhura të tjera | 773,164 | 2.79% |
| Total | 27,733,469 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**1 Me Probleme**
**13 Pa Probleme**

Subjekti Irena Gjoka në vitin 2004 deklaron shtesë aseti llogari bankare në vlerën 23,000 USD, por sqaron që ka pjesë takuese vetëm 4,000 USD (si lekë të kursyera nga puna e të konvertuara në USD) pa dhënë detaje se kujt i përket pjesa tjetër e depozites.

Në vitin 2007 subjekti deklaron shtesë aseti automjet në vlerën 15,000 euro si dhe shtesë llogarie bankare në valuta të ndryshme në total 1,408,103 lekë, ndërsa të ardhura totale për vitin në shumën 2,978,858 lekë, duke rezultuar me burime të pamjaftueshme për të justifikuar shtesën e aseteve në vlerën 255,945 lekë, pa llogaritur në këtë analizë shpenzimet e konsumit vjetor.

Gjatë periudhës deklaruese, subjekti deklaron huamarrje në shumat: 1) 5,000 euro nga babai për blerje automjeti, 2) 2,000,000 lekë dhe 20,000 euro nga vëllai për blerje apartamenti. Nga këto detyrime mbetet detyrim i pashlyer deri me datë 31.12.2017 shuma prej 2,465,100 lekë.